

Znj. Erva Kodra

Në përgjigje të kërkesës tuaj me nr. 6347 prot., datë 21.09.2022, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në lidhje me pasaktësitë që keni konstatuar në pasqyrimin e kontributeve për periudhën janar 2016 – prill 2017, tek "Vërtetimi për bazën e vlerësuar", të shkarkuar nëpërmjet portalit e-Albania, ju informojmë se:

Konform Ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, i ndryshuar "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe VKM nr. 77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor", i ndryshuar, procesi i kryerjes së pagesave të kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, si dhe dorëzimi i listëpagesave të subjekteve paguese bëhet pranë organeve tatimore, të cilat më pas i pasqyrojnë këto të dhëna në sistemin informatik CMIS.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, i përdorin të dhënat mbi pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të pasqyruara në sistemin informatik CMIS, për efekt të dhënies së përfitimeve tek qytetarët, por nuk kanë asnjë akses për të bërë ndryshime në të.

Me mbërritjen e kërkesës tuaj të parë, të cilën ia kishit adresuar ISSH-së në mënyrë elektronike, nëpërmjet portalit online të ISSH-së dhe portalit të bashkëqeverisjes, Drejtoria e Burimeve të Informacionit pranë ISSH kontaktoi me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për të sistemuar pasaktësitë e shfaqura tek "Vërtetimi për bazën e vlerësuar".

Siç ju kemi informuar edhe në formë elektronike në adresën tuaj të e-mailit, ju mund të aplikoni në çdo moment në portalin e-Albania për të marrë vërtetimin e korrigjuar, të gjeneruar me vulë elektronike.

Nga data 1 maj 2022, në zbatim të VKM nr. 252, datë 29.04.2022 “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve online nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, të gjitha aplikimet për shërbimet që ofron Instituti i Sigurimeve Shoqërore realizohen vetëm nëpërmjet aplikimit online, në platformën e-Albania.

Ju faleminderit për mirëkuptimin.

